

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Nëntor 2018

**Tiranë, më 24 Dhjetor 2018:** Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Nëntor 2018, është 646.826, krahasuar me Nëntor 2017, ky tregues rezulton me rritje 2,9 %.


Në Nëntor 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 246.678. Krahasuar me Nëntor 2017, ky numër është ulur me 3,7 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në njëmbëdhjëmujorin e 2018 është 5.646.104 duke u rritur me 16,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Nëntor 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Anglia ka patur rritjen më të madhe me 108,9 %, ulje kanë patur shtetasit nga Kosova me 26,6 %.

Në njëmbëdhjëmujorin e 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe 34,5 % .

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Nëntor 2018, janë 660.514 duke shënuar një ulje me 6,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Nëntor 2018, është 431.279 krahasuar me Nëntor 2017, ky numër është rritur 3,0 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Nëntor 2018, është 229.235. Krahasuar me Nëntor 2017, ky numër është ulur 20,1 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në njëmbëdhjëmujorin 2018, është 4.969.039, duke u rritur 3,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Nëntor 2017	Nëntor 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Janar – Nëntor 2017	Janar – Nëntor 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
<b>Hyrje gjithsej</b>	<b>628.715</b>	<b>646.826</b>	2,9	<b>9.227.637</b>	<b>10.413.020</b>	12,8
Shqiptarë	372.499	400.148	7,4	4.367.411	4.766.916	9,1
Të Huaj	256.216	246.678	-3,7	4.860.226	5.646.104	16,2
<b>Dalje gjithsej</b>	<b>705.760</b>	<b>660.514</b>	-6,4	<b>9.746.467</b>	<b>10.777.106</b>	10,6
Shqiptarë	418.792	431.279	3,0	4.786.963	4.969.039	3,8
Të Huaj	286.968	229.235	-20,1	4.959.504	5.808.067	17,1

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj**

Shtetet	Nëntor 2017	Nëntor 2018	Ndryshim vjetor (%)	Janar – Nëntor 2017	Janar – Nëntor 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	93.819	68.902	-26,6	1.692.136	2.013.887	19,0
Maqedoni	35.480	37.273	5,1	604.220	640.104	5,9
Greqi	32.844	39.670	20,8	460.067	498.435	8,3
Itali	18.929	20.322	7,4	335.215	407.719	21,6
Angli	4.271	8.923	108,9	120.819	118.524	-1,9
Mali i zi	30.074	31.378	4,3	353.966	330.298	-6,7
Poloni	555	490	-11,7	113.911	153.263	34,5
SHBA	4.125	4.543	10,1	93.869	112.900	20,3
Spanjë	610	433	-29,0	21.454	24.044	12,1
Gjermani	4.531	3.198	-29,4	116.585	137.396	17,9
Zvicër	937	1.180	25,9	51.618	51.911	0,6
Të tjera	30.041	30.366	1,1	896.366	1.157.623	29,1
<b>Gjithsej</b>	<b>256.216</b>	<b>246.678</b>	<b>-3,7</b>	<b>4.860.226</b>	<b>5.646.104</b>	<b>16,2</b>

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Nëntor 2017	Nëntor 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Janar – Nëntor 2017	Janar – Nëntor 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
<b>Hyrje Shtetas të Huaj</b>	<b>256.216</b>	<b>246.678</b>	<b>-3,7</b>	<b>4.860.226</b>	<b>5.646.104</b>	<b>16,2</b>
I. Personale	249.651	238.500	-4,5	4.796.933	5.565.547	16,0
1. Pushime	54.900	71.644	30,5	2.318.295	2.711.148	16,9
2. Vizitë në miq e të afërm	1.193	2.048	71,7	17.775	16.412	-7,7
3. Vizitë ditore	20.341	1.110	-94,5	285.781	560.372	96,1
4. Trajtim shëndetësor	155	39	-74,8	615	242	-60,7
5. Qëllime fetare	70	50	-28,6	572	724	26,6
6. Vizitorë të tjerë	162.309	153.555	-5,4	2.010.000	2.098.585	4,4
7. Udhëtarë transit	10.683	10.054	-5,9	163.895	178.064	8,6
II. Biznes dhe profesionale	6.565	8.178	24,6	63.293	80.557	27,3

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Nëntor 2017	87.763	27.515	513.437	99.474	28.033	578.253
Nëntor 2018	95.341	28.239	523.246	108.271	25.192	527.051
Ndryshimi vjetor (%)	<b>8,6</b>	<b>2,6</b>	<b>1,9</b>	<b>8,8</b>	<b>-10,1</b>	<b>-8,9</b>
Janar-Nëntor 2017	1.190.961	704.461	7.332.215	1.231.404	755.964	7.759.099
Janar-Nëntor 2018	1.352.896	743.379	8.316.745	1.379.697	768.901	8.628.508
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	<b>13,6</b>	<b>5,5</b>	<b>13,4</b>	<b>12,0</b>	<b>1,7</b>	<b>11,2</b>

# Metodologji

## Përkufizime

**Vizitorë:** Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”,

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet :** Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>